



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Kom.Dh.Shk.II.nr.993/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit kreditorit "Teuta.Com" Sh.P.K., me NUI: 810055302, me seli në Prizren, të cilin e përfaqëson A.A. avokat nga Prizreni, kundër debitorit "Swiss Bau" Sh.P.K., me, NUI 810050815, me seli në Prizren të cilin e përfaqëson sipas autorizimit V.O. avokat nga Prizreni, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.777/22 të datës 25.05.2023, me datë 20.09.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e kreditorit "Teuta.Com" Sh.P.K., me NUI: 810055302, me seli në Prizren, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.777/22 të datës 25.05.2023 **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.777/22 të datës 25.05.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit "Teuta.Com" Sh.P.K., me NUI: 810055302, me seli në Prizren dhe e ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.1000/2021, të datës 20.10.2021, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Enis Hoxha ashtu që e ka përfunduar në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori "Teuta.Com" Sh.P.K., me NUI: 810055302, me seli në Prizren, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të drejtës materiale, dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të LPP-së, me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin e Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.777/22 të datës 25.05.2023, me propozim që të aprovet si e bazuar ankesa e kreditorit ashtu që të priset aktvendimi i gjykatës së shkalës së parë, dhe të refuzohet prapësimi i debitorit

Përgjigje në ankesa ka parashtruar debitori me propozim që Dhomat e Shkallës së Dytë ta refuzojnë ankesën e kreditorit si të pabazuar dhe ta vërtetojë aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.777/22 të datës 25.05.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori "Teuta.Com" Sh.P.K., me seli në Prizren, me datë 20.10.2021 ka paraqitur propozim për përmbaremore për lejimin e përmbaremit kundër debitorit "Swiss Bau" Sh.P.K, mbi bazën e faturave në cilësi të dokumenteve të besueshme, për shumën e borxhit prej 67,767.56 €.

Përmbareuesi Privat Enis Hoxha, në Prizren, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka caktuar urdhrin P.nr.1000/21 me datën 20.10.2021, duke lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës nr.1a-2021 të datës 21.09.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin "Swiss Bau" Sh.P.K., me seli në Prizren, që në emër të borxhit sipas faturës me numër 1a-2021 e datës 21.09.2021, t'ia paguaj shumën prej 67,767.56 €, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së propozimit për përmbaremore si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbaremit me dhunë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.777/22 të datës 25.05.2023 me të cilin e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit "Teuta.Com" Sh.P.K., me NUI: 810055302, me seli në Prizren dhe e ka anuluar urdhrin përmbaremore P.nr.1000/2021, të datës 20.10.2021, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Enis Hoxha ashtu që e ka përfunduar në tërësi përmbaremi në këtë çështje përmbaremore.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se dokumenti – Fatura nr.1a-2021 e datës 21.09.2021, në bazë të cilave është lejuar propozimi për përmbaremore nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin e pranuesit – debitorit, andaj, meqenëse debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën, ndërsa nga dëftesa për pranimin e dërgesës me numër 1840325 e datës 22.09.2021 e cila gjendet në shkresat e lëndës, sipas kësaj dëftese nuk mund të konstatohet si dorëzim i rregullt, ngase konstatohet nënshkrimi i marrësit i dorëzuesit, por te lloji i dërgesës nuk ka shënim se cila dokumente janë dorëzuar por figuron vetëm shkronja R.

Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se në bazë të kësaj dëftese nuk mund të konstatojë se ky dorëzim është i rregullt, në mungesë të shënimeve tek lloji i dërgesës, pra nuk mund të argumentohet se janë dorëzuar faturat apo ndonjë dokument tjetër tek debitori, ndërsa nuk ka dëshmi se kjo faturë është dorëzuar në ndonjë mënyrë tjetër.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se fatura e lëshuar nga ana e kreditorit nuk janë pranuar me rregull ngase të njejtat nuk janë të nënshkuara nga kreditori – gjë që e bën faturën të papranueshme dhe si e tillë e njëjta nuk i përmbush kushtet e dokumentit të besueshëm.

Dhomat e Shkallës së Dytë sqarojnë se në raportin afarist mes palëve lëshimi i faturave duhet t'i përmbajë të gjitha kushtet ligjore nga Neni 29 par. 3 i LPP-së i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Bazuar në kushtet e përcaktuara me këtë dispozitë ligjore fatura nuk mund të ketë fuqinë e dokumentit të besueshëm nëse mungon ndonjë nga kriteret që e bën atë të përshtatshëm për përmbartim. Fakti se kreditori nuk e ka pranuar faturën me nënshkrimin e tij, nuk i jep faturës fuqinë e dokumentit të besueshëm dhe i njëjti nuk mund të jetë i përshtatshëm për përmbartim. Sipas qëndrimit juridik të kësaj gjykate, në procedurën përmbartimore që rrjedh nga një raport afarist palët duhet t'i mbështesin pretendimet e tyre mbi dokumente të cilat janë të pranueshme për ndjekjen e procedurës në gjykatë. Së këndejmi, fakti se njëra palë i ka dërguar disa fatura përmes dërgesës postare tek pala tjetër nuk nënkupton dërgim të rregullt, përderisa debitori nuk ka pasur njohuri për përmbajtjen e dërgesës. Kjo mënyrë e të dorëzuarit të faturave, ndonëse pala i pranon fizikisht faturat në dërgesë, nuk nënkupton se ka pranuar detyrimin që bartin ato. Pra, që faturat të kenë fuqinë e dokumentit të besueshëm do të duhej që të njejtat të jenë të nënshkuara nga debitori apo dërgesa të jetë e qartë se cka përmbanë. Në të kundërtën vetëm dërgimi i tillë postar pa u specifikuar se cka pranon debitori është devijim i kushteve ligjore dhe pranueshmërisë së detyrimit që përmbajnë faturat dhe për gjykatën nuk paraqet pranim të faturës.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e shkallës së dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.993/23 dt. 20.09.2023

**Gjyqtari,
Dren Rogova**